



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 25 prill 2012

**Përforcimi i kapaciteteve administrative në nivel qendror
dhe lokal për implementimin dhe vënien në fuqi të
legjislacionit për menaxhimin e mbeturinave
*(Projekt i financuar nga BE-ja)***

Fjalim
Aivo Orav
Shef i Delegacionit të
Bashkimit Evropian

I nderuari Ministër Ademi,

Zonja dhe Zotërinj,

Kam nderin t'u uroj mirëseardhje sot këtu, në Qendrën Informative të BE-së. Do të doja të falenderoj nga zemra të gjithë folësit dhe pjesëmarrësit në ngjarjen e sotme.

Politika e BE-së për menaxhimin e mbeturinave ka për qëllim të zvogëlojë dëmet që i bëhen ambientit jetësor dhe shëndetit nga mbeturinat, dhe të përmirësojë efikasitetin e resurseve të Evropës. Është një nga politikat më të vështira dhe më të shtrenjta për zbatim. Ky sektor është i rëndësishëm në procesin e anëtarësimit. Implementimi i legjislacionit për menaxhimin e mbeturinave është pjesë e prioriteteve afatshkurta të Partneritetit për Anëtarësim.

Vendi është duke pranuar ndihma nga BE-ja, me anë të Instrumentit Para-Anëtarësues, mirëpo barra kryesore financiare shtrihet në buxhetin kombëtar. Implementimi i acqui-së për mjedisin kërkon investime të mëdha. Këto shpenzime paraqesin një sfidë të madhe për vendin.

Për të ndihmuar procesin e vështirë të reformave në sektorin e ambientit jetësor, BE-ja vazhdon të ofrojë ndihmëm, si për zhvendosjen ashtu edhe për implementimin e ligjit:

- Në periudhën e kaluar, për përkrahjen e vendit, u shpenzuan 47.6 milionë euro nga Programi CARDS, i menaxhuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim. Kjo ndihmë u shfrytëzua për harmonizimin e legjislacionit për ambientin jetësor, implementimin e legjislacionit, ndërtimin e objekteve infrastrukturore, furnizimin e pajisjeve të nevojshme, si dhe për kontributin për zhvillimin e vazhdueshëm të komunave dhe OJQ-ve në zonat kufitare.
- Ndihma e BE-së në sektorin e ambientit jetësor po vazhdon në suaza të Programit IPA. Deri më tani, 54 milionë euro janë dedikuar për aktivitetet e ndërtimit institucional si dhe për projektet investuese.

Sfida kryesore e sektorit për menaxhimin e mbeturinave, tani ka të bëjë me:

- 1) harmonizimin e vazhdueshëm të legjislacionit me *acquis*-në;
- 2) kapacitetin e shtuar administrativ të institucioneve për implementimin e legjislacionit mbi ambientin jetësor; dhe
- 3) kapacitetin e përmirësuar të planifikimit dhe implementimit të projekteve investuese.

Implementimi efektiv dhe vënia në fuqi ka nevojë për inkuadrimin e të gjithë pjesëmarrësve.

Diskutimet aktuale janë një hap në drejtim të duhur. Për të fituar ndihmën, inkuadrimi aktiv i aktiviteteve kombëtare dhe i pjesëmarrësve është jashtëzakonisht i rëndësishëm në mënyrë që të arrihet sukses në krijimin dhe implementimin e sistemit të integruar për menaxhimin e mbeturinave. Ekzistojnë dy aspekte të rëndësishme që duhen marrë parasysh për financimin e menaxhimit të mbeturinave:

- 1) si të financohen shpenzimet e investimit të kapitalit për sigurimin e pajisjeve dhe infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave; dhe
- 2) si të financohen shpenzimet korrente që shkaktohen gjatë funksionimit.

Rrjedhimisht, një politikë e kompenzimit të shpenzimeve për menaxhimin e mbeturinave, duhet të përcaktojë:

- shumën e përgjithshme të financimit të rregullt të nevojshëm për vitin e ardhshëm; dhe
- si do të sigurohet kjo.

Shuma minimale e financimeve të rregullta duhet të përfshijë: 1) shpenzimet e funksionimit të drejtpërdrejtë dhe 2) detyrimet e shërbimit të borxheve. Duhet të sigurohen të ardhura të mjaftueshme, për të mbuluar rrjedhjen vjetore të parave të thata. Synimi përfundimtar i një aftësie ose shërbimi është të bëhet vetë-financues. Për këtë nevojiten lehtësime që do të krijojnë dhe do të vënë mënjanë fonde të mjaftueshme për të ruajtur vlerat e aseteve, për financimin afatgjatë të detyrimeve dhe të sigurojë kthimin e investimeve.

Evenimenti i sotshëm është pjesë e procesit të inkuadrimin të pjesëmarrësve dhe duhet të kontribuojë për të kuptuar më mirë parimin e "pagesës së ndotësve". Kjo, nga ana tjetër, do të mundësojë zbatimin më të mirë për një qasje të re në financimin e menaxhimit të mbeturinave në të ardhmen.

Zonja dhe Zotërinj,

Implementimi i legjislacionit për menaxhimin e mbeturinave është proces i ndërlikuar dhe i vështirë, mirëpo do t'i sjellë qytetarët më afër standardeve të BE-së në fushën e ambientit jetësor. Unë ju inkurajoj të këmbeni informatat tuaja lidhur me këtë temë të rëndësishme.

Falemnderit!